

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opštine Vuçitrn / Municipality Vushtrri



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 67, pika "f" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni profesional për vlerësimin e gjendjes teknike të rrugës Vushtrri-Sllatinë-Tërllabuq në këtë përbërje:
 - 1.1. Nexhat Merovci ingj. I ndert. kryetar,
 - 1.2. Ramiz Maliqi, ark. anëtar,
 - 1.3. Isa Latifi , gjeodet. anëtar
2. Komisioni obligohet që me datën 04.07.2019 të dal në teren dhe të bëjë vlerësimin e gjendjes teknike dhe të hartoj raport me shkrim lidhur me gjendjen e rrugës.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. T'iu dërgohet nga një kopje anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. 876/19

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 09.07.2019

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Ekonomi bujqësi pylltari dhe zhvillim rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR KORRJE-SHIRJE


1. Me këtë vendim formohet komisioni për përcjellje të fushatës së korrje-shirjeve në këtë përbërje:
 - 1.1 **Miran Halili**, kryesuese e shtabit (Drejtor për EBPZHR)
 - 1.2 **Rabije Zahiti**, anëtare (DEBPZHR)
 - 1.3 **Avdyl Feka** anëtar (DEBPZHR)
 - 1.4 **Bajram Beqiri**, anëtar (DMSH)
 - 1.5 **Rasim Mlinaku**, anëtar (DI)
2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi do të përcjell përkatësisht monitoroj mbarëvajtjen e fushatës së korrje shirjeve në territorin e komunës së Vushtrrisë si dhe të hartoj raport me shkrim për organet kompetente lidhur me përfundimin e fushatës si dhe rendimentet e arritura nga korrje shirjet.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, neni 4 pika 6 dhe neni 6 pika 5 dhe neni 21 të Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, si dhe në bazë të propozimit të Zyrtarit Kryesor Financiar të komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formohet komisioni i përkohshëm për vlerësim të pasurisë jo financiare të komunës, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Ramiz Maliqi**, inxh. i arkitekturës - kryesues
 - 1.2 **Fortuna Krasniqi**, inxh. e arkitekturës - anëtare
 - 1.3 **Ilirijana Azemi**, jur. e dipl. - anëtare
 - 1.4 **Rexhep Gërguri**, ekonomist - anëtar
 - 1.5 **Islam Latifi**, inxh. i komunikacionit – anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiare të komunës të cilat vlerën financiare në kontabilitet e kanë zero. Në rast se mungojnë informatat financiare për vlerën e tyre atëherë komisioni vlerësues do të i caktoj një vlerë sa më reale në bazë të kriterëve dhe metodave standarde të vlerësimit.
3. Komisioni do të fillojë me punë me vlerësim të automjeteve zyrtare të komunës që do të nxirren në ankand publik, si dhe rastet tjera sipas nevojës përkatësisht kërkesave për vlerësim të pasurisë brenda vitit 2019.
4. Komisioni ka mandat deri më 31.12.2019.
5. Komisioni, gjatë punës së tij do të bashkëpunojë me zyrën për regjistrim të pasurisë.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUCITRN	
02 Nr. / Br	895/19
No. i fq. / Br. sh	-02-
Data / Datum	11.07.2019
VUSHTRRI - VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI
VUSHTRRI MUNICIPALITY / OPSTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 10.07.2019 merr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

Neni 1

KONSTATOHET se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik-realizimi i projektit për rregullimin e trotuarit në rrugën "Bekim Berisha Abeja" në Vushtri, Komuna Vushtri, për pjesën e parcelës kadastrale si në vijim

: • P-70202016-02096-0, në sipërfaqe prej 155 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4777 m², ZK-Vushtri, pronar në pjesë ideale 1/1 Kimete Aliu nga Vushtria, Komuna Vushtri.

Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.

Neni 4

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, konform nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe

plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. Ankesa mund të paraqitet nga pronari ose zotërues i interesit në pronën e prekur nga ky vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës pas një analize të raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – qershor 2019, në takimin e rregullt me drejtor të drejtorive mbajtur më 22.07.2019, jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Urdhëroj të gjithë Drejtorët e Drejtorive që gjatë punës dhe aktiviteteve të tyre, të ndërmarrin masa të duhura për kursim të shpenzimit të mjeteve buxhetore të komunës nga kategoria mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet komunale (shpenzimet e karburanteve të automjeteve zyrtare, shpenzimet e telefonisë, dreka zyrtare etj.) me qëllim të zvogëlimit të shpenzimit të atyre mjeteve. Nevoja për ndërmarrje të këtyre masave ka dal si rezultat i rritjes së këtyre shpenzimeve krahasuar me vitin paraprak, bazuar në raportin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar – qershor 2019.
2. Masat e kursimeve të zbatohen deri në atë masë sa të mos vie në pyetje realizimi i punëve të përditshme gjegjësisht projekteve të planifikuara.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Urdhëresa i dërgohet:

- Drejtorëve të Drejtorive
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPËSTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br. 941/19

Nr. i fq. / Br. st.

Data: / Datum 26.07.2019

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 810129157, dt. 15.07.2019 në shumë prej 576.00 € (pesqindeshtatëdhjetëegjashtë euro) - për shpenzime të krijuara në Hotel “Amazona” në Obiliq, me rastin e vizitës së Kryeministrit të Kosovës me bashkëpunëtorë në Komunën e Vushtrrisë.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.